



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:285847

Datë: 28.06.2022

Numri i dokumentit: 03178199

PKR.nr.66/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DepA.menti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Fatos Sejdiqaj dhe Nikolla Petronijeviq, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj në çështjen penale kundër të akuzuarve A.H nga Komuna e ... dhe A.M nga fsh.... Komuna e ..., për veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par.2.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – DepA.menti për Krime të Rënda PP.I.nr.333/2021 e dt.14.03.2022, e rikualifikuar nga ana e Gjykatës në veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, seanca e mbajtur në prezencë të Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit A.H dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.Shyqyri Sylja si dhe të akuzuarit A.M dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.Arlind Jupolli dhe të dëmtuarit Y.K, pas mbajtjes të seancës së shqyrtimit gjyqësor në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, me datë 16.06.2022, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.28.06.2022:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. A.H, nga i ati M., e ëma E., e gjinisë Zh., i lindur me dt...., në Komunën e ... ku dhe jeton në rr.“...” nr....., me nr.personal ..., i pa punë, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i vetëpunësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, nën masën e paraburgimit që nga dt.17.12.2021 deri me dt.16.06.2022.

2. A.M, nga i ati S., e ëma M., e gjinisë D., i lindur me dt.... në fsh.... Komuna e ..., tani me vendbanim në fsh.... Komuna e ... me nr.personal ..., me profesion fasader, i vetëpunësuar, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, nën masën e paraburgimit që nga dt.17.12.2021 deri me dt.16.06.2022

JANË FAJTOR

SEPSE: Me dt.14.12.2021 në intervalin kohor prej 00:00 min. e deri në ora 11:00 min., në fsh.Stanovc Komuna e Vushtrrisë saktësisht në ambientet e motelit “H.”, të akuzuarit sipas marrëveshjes paraprake në mes veti e mashtrojnë të dëmtuarin Y.K, e dërgojnë në motelin “H.”

aty ushtrojnë dhunë fizike dhe psikike në atë mënyrë që i akuzuari A.1 me dashje e fton të dëmtuarin Y.K me qëllim që ta mbaj për ta detyruar të njëjtin, të pranoj-kryej një veprim që nuk e kishte bërë, kinse ka pasur marrëdhënie seksuale me dashnoren e të akuzuarit A.1, në atë mënyrë që fillimisht i akuzuari A.H e fton të dëmtuarin për të shkuar në motelin e cekur si me lart, ku fillimisht hyjnë në dhoma të veçanta pastaj më vonë i akuzuari A.H e fton të dëmtuarin Y.K që hyjnë në dhomën nr.9 ku ka qëndruar i akuzuari A.1 dhe aty fillimisht diskutojnë problemin e më vonë e kanos me fjalët se “kam me ta nxjerr shpirtin derisa të pranosh se ke pasur marrëdhënie seksuale me A.2”, më vonë në mëngjes rreth orës 10:00 minuta vjen edhe i akuzuari A.2 ku të dy fillojnë të ushtrojnë dhunë psikike dhe fizike duke e rrahur të dëmtuarin Y., fillimisht i akuzuari A.M e godet me grushte në kokë dhe pjesë të ndryshme të ndryshme të trupit, me qëllim të detyrimit që i dëmtuari Y.K ta pranoj një fakt që fare nuk ka ndodhur, kinse ka pasur marrëdhënie seksuale me dashnoren e të akuzuarit A. – A.T, të akuzuarit vazhdojnë duke e mallretuar fizikisht dhe psiçikisht të dëmtuarin Y.K e më pas i akuzuari A.1 e kanos me fjalët “kam me të dërgu në Shqipëri o qen se më ke pre në besë deri sa të mi sjellësh 50.000 Euro”, i akuzuari A.M largohet nga moteli pas 10 – 15 minuta pasi që ka shkuar aty ndërsa rreth orës 11:00 pronari i motelit i largon të akuzuarin A.H dhe të dëmtuarin nga moteli, veprime këto të ndërmarra nga të akuzuarit me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, nga këto veprime të të akuzuarve, i dëmtuari Y.K pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin sipas Ekspertizës Mjeko-Ligjore e dt.21.02.2022.

Me këtë kanë kryer veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 42 dhe 69 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së:

SHQIPTON

I. Të akuzuarit A.H:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti e katër (4) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit që nga dt.17.12.2021 deri me dt.16.06.2022.

II. Të akuzuarit A.M:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit që nga dt.17.12.2021 deri me dt.16.06.2022.

III. Obligohen të akuzuarit që të paguajnë secili veç e veç dhe atë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 100€ (njëqind euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

IV. Pala e dëmtuar Y.K për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore Mitrovicë – DepA.menti për Krime të Rënda pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë – DepA.menti për Krime të Rënda ka parashtuar Aktakuzën PP.I.nr.333/2021 e dt.14.03.2022, kundër të akuzuarve A.H dhe A.M për veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par.2.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. Rrjedha e procedurës

Gjykata në këtë çështje penale ka procedura duke ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore ku me dt.30.03.2022 është caktuar dhe është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë ka prezentuar Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, i dëmtuari Y.K, i akuzuari A.H dhe mbrojtësit e tij sipas autorizimit av.Shyqyri Sylva, av. Rifat Bllata dhe av.Beqir Halili ku si mbrojtës kryesor është caktuar mbrojtësi av.Shyqyri Sylva, po ashtu ka prezentuar i pandehuri A.M dhe mbrojtësit e tij sipas autorizimit av.Arlind Jupolli dhe av.Basri Jupolli ku si mbrojtës kryesor është caktuar mbrojtësi av.Arlind Jupolli.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të akuzuarve j'u është dhënë mundësia ligjore sa i përketë deklaramit të tyre lidhur me fajësinë. Të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me veprën penale për të cilën janë akuzuar nga ana e Prokurorisë. Pasi që të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm j'u është dhënë mundësia ligjore që brenda afatit të përcaktuar të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat me kërkesën për hudhjen e aktakuzës.

Të akuzuarit përmes mbrojtësve të tyre kanë paraqitur brenda afatit të përcaktuar kundërshtimet për provat me kërkesën për hudhjen e aktakuzës. Gjykata ka marrë Aktvendimin PKR.nr.66/22 i dt.20.05.2022, me të cilin ka refuzuar kundërshtimet për provat me kërkesën për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga mbrojtësit e të pandehurve. Ndaj këtij Aktvendimi mbrojtësi i të pandehurit A.M, av.Arlind Jupolli ka paraqitur ankesë mirëpo i njëjti përmes parashtesës së dt.06.06.2022, e ka njoftuar se është tërhequr nga ankesa dhe Aktvendimi i lartcekur është bërë i formës së prerë.

Me dt.13.05.2022 dhe dt.15.06.2022, janë caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit fillestar në Prezencën e Prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarve dhe mbrojtësve av.Shyqyr Sylva, av.Rifat Bllata dhe av.Arlind Jupolli, ku në këto seanca nuk kanë prezentuar mbrojtësit av.Beqir Halili dhe av.Basri Jupolli edhe pse të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt. Në seancën e dt.15.06.2022, i akuzuari A.H e ka njoftuar Gjykatën se ka revokuar autorizimin për mbrojtësin av.Rifat Bllata. Në seancat e shqyrtimit gjyqësor po ashtu kanë prezentuar edhe dëshmitarët M.Sh dhe R.M, ndërsa me dt.16.06.2022 është bërë shpallja publike e aktgjykimit.

III. Dëgjimi i dëshmitarëve

III/1. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.13.06.2022, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari Y.K dhe i njëjti ka theksuar se kam dhënë deklarata në polici dhe në prokurori çka kam thënë ajo qëndron, rreth orës 10 në mbrëmje më ka thirrur A.1i më ka thënë hajde në lokal, kam qenë në shtëpi në fsh....., prindi më ka thënë ku po shkon në këtë kohë, i kam thënë tek A.1 se e kam shok, kam vazhduar kam shkuar në lokal të A.1 në lokalin Muzika M. në fsh.Stanovc, i kam pirë dy birra, kam ndenjor rreth 1 orë aty, ka pasur muzikë në lokal, ka pasur edhe njerëz, kam vazhduar pasi që e kam paguar cekun deri në Pestovë, më ka thirrur prapë A.1, jam kthyer, ka ardhur A.1 dhe më ka thënë dil në parking se po shkojnë deri në një motel, kemi vazhduar e ka lënë kerrin e tij në parking të lokalit, kemi shkuar në motel, më ka

paguar një dhomë tjetër, pas disa minutave më ka thirrur hajde në dhomë tjetër, më ka thënë shkojna në motel se i kemi do shoqe, kam hyrë në dhomë, e kam parë që nuk është situata mirë, kam dashur që të thirri një shok temin, mirëpo nuk më ka lejuar A.1 pasi që më ka kapur telefonin, më ka thënë më ke pre në besë, nuk kam mundur që të lajmërojë kërkon, më ka thënë qetash e sheh edhe pak se çka është puna, ora ka qenë mbas orës 12 të natës, ndoshta edhe më vonë, saktë nuk e di, tanshi dikur më vonë kanë filluar sharje, dikur më vonë e ka thirrur edhe A.2, ka ardhur edhe A.2, i njëjti ka ardhur dhe me një bisht të sopatës më ka goditur katër herë, nuk më kujtohet kur ka ardhur A.2, orën e saktë nuk e di, dikur pasi që është kryer ngjarja ka ardhur pronari i hotelit e ka qelur derën, A.2 nuk ka qenë aty pasi që ka ardhur pronari, si ka ardhur A.2 më ka goditur me bisht të sopatës dhe i ka thënë A.1 që ky është që na i ka qit qipat pastaj e ka kuptuar që po më rrahin për një femër A.T-A., pastaj A.1 ka incizuar me telefon temin, edhe për të më shpëtuar mua, djali im e ka pasur Facebookun tim qelun dhe kjo ka qenë arsyeja që është lajmëruar rasti, kur i njëjti i ka dërguar incizimet nga telefoni im në telefonin e tij incizimi i ka shkuar edhe djalit tim, kur ka ardhur punëtori i hotelit i njëjti ka dëgjuar zhurmat mirëpo nuk e ka thirrur policinë dhe e ka thirrur pronarin e tij dhe i njëjti ka ardhur tek dhoma, ka folur me A.1 dhe i ka thënë që kam një problem familjar, i ka thënë probleme zgjidhi tjetër kund jo këtu, më ka parë mua më ka thënë Y. se çka ki i kam thënë kemi bërë ndeshje, nga frika nuk i kam treguar se çka kam, kur kam dalur nga moteli i kam ndalur disa vetura por asnjëra nuk më ka ofruar mundësi që të thirri familjen, kur kam shkuar në shtëpi pastaj familja më ka dërguar në Skenderaj në Spital, tani dikur i kam thirrur policinë në Vushtrri, të njëjtit kanë ardhur tek U. G., më kanë marrë më kanë dërguar në spital në Vushtrri pastaj më kanë dërguar në Prishtinë, nuk kam pasur që të lajmëroj rastin mirëpo i njëjti e ka përhapur në të gjithë shoqërinë se unë i kam ngjitur qipat në kulet, pastaj kam ardhur në polici në Mitrovicë, telefonin ma ka marrë A.1, brenda me ne ka qenë një femër që nuk ja di emrin po ashtu edhe K.I, kur më është marrë telefoni A.1 tha kush na i vidhi telefonat, thash nuk e di sepse kam qenë 8 vite në burg, nuk di as me vierlles ta lidhi, A.1i më ka thënë më kë pre në besë diçka, tha ke pasur punë me A.T në vendin e caktuar, tha ke pasur marrëdhënie seksuale me të, i kam bërë be që jo mirëpo dikur nga dhuna e kam pranuar që po, pasi që 3 apo 4 muaj ma herët me kerrin tem tek rrethi i Ismetit në Prishtinë, kemi qenë së bashku, A.1 kishte pasur një urdhërarrest dhe këtë e morri policia, unë nuk kisha patentë shofer nuk kam mundur që të voziti, ka ardhur A. dhe me të njëjtën kemi shkuar e kemi marrë automjetin në polici dhe kemi pritur në Gjakovë A.1 deri në ora 8 në mëngjes, aty më ka thënë që kam pasur marrëdhënie me A., nga dhuna që më është bërë e kam pranuar që kam pasur marrëdhënie me të, nuk kam mundur që të dal nga aty nuk kam pasur mundësi kurqysh, disa herë jam matur që të kërcëj nga xhami mirëpo nuk kam pasur mundësi, kur e kam pranuar që kam pasur marrëdhënie A.1 më ka thënë që është dashur më herët që ta pranosh dhe më ka ofenduar më ka thënë o qen, pastaj kanë dashur që të më dërgojnë në një vend tjetër, dhe nga biseda që kam dëgjuar që e kanë pasur me atë femrën kam dëgjuar që kanë dashur të më dërgojnë në Shqipëri, qëllimi i të akuzuarve ka qenë për përfitim pasuror, që të më marrin para, është përmendur gjatë një bisede me telefon se 50 mijë euro duhet që të mi biesh, më ka thënë edhe mua në dhomë, më ka thënë edhe “se e kam pasur grua”, është e vërtetë, jemi shok me A.1 që nga viti 2009, kemi qenë në burg me të, kur kam dalur nga burgu kam vazhduar shoqërinë, me të, kemi ndenjor shpesh me të gjatë kësaj kohë, i kam marrë para hua 5000 euro, i kam lërë borxhin, i ka pru babit tim orë në vlerë 1000 franga, më ka thënë disa herë sa ka qenë në Zvicër që hajde atje dhe rrim, e kam dashur shumë si shok, kam qenë në gjendje që të bëjë gjithçka për të, edhe familja ime nuk do

të kishte besuar që A.1 më ka bërë këtë, nuk më kishin besuar sikur mos të ishin incizimet, në motel kemi shkuar se më ka thënë i kam do shoqe dhe të konsumojmë edhe kokainë, atyre shoqeve nuk ja di emrat, ka qenë një qikë e Ferizajit, ato kanë qenë brenda, kjo ka qenë në motel nga fillimi, pastaj kemi shkuar kur është kryer orarin në lokal dhe i kemi marrë edhe dy punëtore dhe atyre i ka paguar një dhomë tjetër, në motel H. kam shkuar mbas orës 10 në mbrëmje, nuk më kujtohet saktë, më ka paguar dhomën, dhe e kam futur në garazh veturën time, pas disa minutave ka ardhur më ka thënë hajde në dhomën time, pastaj kam shkuar, në dhomë kishte qenë K.I dhe ajo qika nga Ferizaji që nuk ja di emrin, dy punëtorët e tjera kemi shkuar pas gjysmë ore i kemi marrë, nuk e di a kemi shkuar me veturën time apo të A.1, aty kam dyshuar që dojnë të më rrahin, siç deklarova më lart, K. është shok i të dyve i imi dhe i A.1 e njoh që dy vite, kam pirë dikun rreth 12 apo 13 copa birra duke i përfshirë edhe të lokalit dhe të motelit, kokainë kam përdorur unë dhe K., po ashtu edhe A.1, ata e kishin pasur aty, kokainën nuk e di ku e kanë marrë K. dhe A.1, aty kanë qenë dikun rreth 4 qese të vogla 0.5 gram, kam qenë përdorues i drogës mirëpo tani nuk jam, prej momentit kur kemi filluar që të konsumojmë birra dhe alkool ka zgjatur dikun rreth 3 apo 4 orë, A.1 më ka marrë telefonin pasi që më tha më ke pre në besë diçka, rrahja ka ndodhur me pushime deri në momentin kur e kam pranuar, herën e parë kur ka ardhur A.2 më ka goditur me bisht të sopatës, në këmbë, pastaj A.1 më ka incizuar dhe më ka thënë të pranoj, A.2 nuk ka ndenjtur shumë dhe ka ecur, i ka thënë qysh më thirre për qipa pastaj dul për femër, A.2 nuk ka qenë kur e kam pranuar, pastaj unë nuk jam liruar që të eci në shpi deri sa ka ardhur R. pronari i hotelit, e kam pranuar që kam pasur marrëdhënie me A.T dhe të njëjtën e njoh që rreth 2 vite në bazë të A.1, e kam ditur që A.1 me A. janë në lidhje dashurie, i kam dy gra edhe vet unë, mund të them që asnjë fjalë nuk i kam thënë A. për shkak të lidhjes që e kanë pasur, por A.1 e ka shti dikush atë ditë, kur ka ardhur pronari i motelit ka qenë mbas orës 13:00 minuta, e ka goditur derën dhe ka thënë hape derën, po ashtu edhe përmes dritares, dhe ka kërkuar që menjëherë që të dalim jashtë, kemi dalur menjëherë dhe kam hypur në makinën time dhe kam ecur në shpi, kam shkuar drejtë në shpi, pastaj jam kthyer tek hotel U. G., e kam thirrur policinë, aty ka qenë A.1i, e kam përcjellë me kerr aty ka hyrë në atë hotel, kanë ardhur policia dhe e kanë arrestuar, tek U. G. kam qenë me djalin tim E., vëllaun Xh. dhe me një shokë O.S, e kanë ditur për qka po shkojmë, vëllau ka folur me A.1 dhe i ka thënë pse e keni rrahur, A.1 i ka thënë për shkak të disa qipave, ndoshta ka qenë edhe djali i motrës aty, pasi që unë atëherë kam filluar t'i ndiej dhimt pasi që më ka lëshuar kokaina, para se ta thërras policin e kam thirr A.1 i kam thënë thuaj që kemi bërë ndeshje, kemi shkuar ndoshta edhe e kishim rrahur A.1, jam pajtuar me familjen M., pasi që i njëjti është prerë në besë pasi që e di kur e ka thirru i ka thënë që hajde se e nxana tjetrin shpiun, pastaj e ka kuptuar që po më rrah për femër, jemi pajtuar pa kushte, nuk kam kërkuar shpërblim, nëse është kjo e vërtetë, është e vërtetë se i kam thënë vëllaut mos bë asgjë, ju kam thënë familjarëve të mijë që mos të keni punë me A.1 pasi që nuk kam dashur që të njëjtit të hyjnë në burg, këtë punë kam dashur ta kryej vet, familja e A.1 më ka dërguar njerëz për marrëveshje për pajtim sipas traditave zakonore, nuk i kam pranuar, ka ardhur vëllau i A.1 i cili vetëm atë e kemi pranuar, ai quhet D., i kam thënë që le të punon lokali unë nuk kam punë me juve përveç me A.1, tani nuk i kam borxh askujt, nuk është e vërtetë që i kam vendosur qipa, kam të kryer shkollën tetë vjeqare, shkollën e mesme e kam përfunduar privat, femra që ka qenë në dhomë ka qenë punëtore e A.1 atë e kam njohur vetëm dy ditë më herët në lokal, K. vetëm ka qenë aty është shok i imi dhe i A.1, A.2 vetëm e kam njohur që ka qenë sigurim tek lokali i A.1 dhe nuk kam pasur probleme asnjëherë me të njëjtin, nuk mendoj që ka qenë

qëllimi i A.2 të përfitoj diçka prej meje, koha sa ka qëndruar A.2 nuk mundem ta dijë saktë mirëpo dikun 15-20 minuta nuk më kujtohet saktë.

III/2. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar M.Sh dhe i njëjti ka deklaruar se rasi më kujtohet pak ka ndodhur para 5 apo 6 muajsh, kam qenë aty si pastrues kam fshir dhoma tjera, dhe kam qenë duke u shtetitur në oborr, e kam dëgjuar një zhurmë, e kam thirr shefin për të pru bukën dhe me lajmëru për këtë rast, e kam thirr dhe ai ka ardh për 5 apo 6 minuta nuk e di saktë, zhurma ka qenë e zakonshe jo ku me ditë çfarë zhurme, një zë, ka qenë zë mashkulli sa më kujtohet, zhurma ka qenë normale, në stacion policor kam dhënë dëshmi dhe është nënshkrimi im në deklaratën e dhënë në polici, ngjarja ka ndodhur që 5 apo 6 muaj dhe që të dyja janë të vërteta ajo që kam thënë atje dhe kjo që thash sot në seancë, e kam thirr shefin për të pru bukën dhe i kam thënë pe ndiej një zhurmë, më ka thënë vazhdo ti punën tënde dhe unë kam vazhduar pastaj ka ardh shefi dhe është merr me të, nuk më kujtohet se çka ka vepruar R. kur ka ardhur, e kam pastruar dhomën ku kanë qenë këta persona ka qenë normal, kanë qenë do shishe të birrës, do cigare, mbeturina kështu diçka, shishe të birrës nuk kanë qenë të thyera, ndrrimin e kam filluar në orën 7 të mëngjesit dhe nuk e kam parë ndokënd duke hi apo duke dal.

III/3. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar R.M dhe i njëjti ka deklaruar se e kam dhënë një dëshmi në stacion policor ditën kritike kam qenë për vizitë familjare tek një dajë i imi, kolegu që ka punuar aty më ka thirr M.Sh, më ka thirr më ka thënë hajde se është një zhurmë, i kam thënë hajt se nalet, e kam marrë nipin djalin e vëllaut A.M që është pronar i hotelit dhe kemi shkuar aty, kam ardhur në motel kam trokitur në dritare, i kam thënë për 5 minuta me dal nga aty, janë bë 3 minuta i kam thënë me dal menjëherë nga aty, ka dal ai mbrapa A.1 që tani është këtu ulur, ka thënë a bënë një Coca Colë, i kam thënë nuk ka kurgjo dilni, pastaj prapë i kam trokitur dhe kanë dalur A.1 ka hyp në kerr të vet ai tjetri në kerr të vet dhe kanë dalur, e kam vërejtur që Y. ka një mavijosje në fytyr ka thënë kam bërë ndeshje, kurse A.1 ka thënë i kam rreh, pastaj është kthyer Y. ka thënë i kam harruar 10 euro, ja kam dhënë 10 euro të mijat dhe i kam thënë nuk keni çka lypni ma këtu, ka qenë ndrrimi i masditës, kanë ardhur në ndrrimin e natës, nuk e di si kanë ardhur, kam qenë në ndrrimin e masditës jo të natës, është e vërtetë ajo çka kam deklaruar në polici se “A.1 me këtë djalin e ri e kemi vërtetuar që është K.I, kanë ardhur me dt.13.11.2021 rreth orës 21:00, dhe kanë marrë dhomën numër 3, më vonë janë transferuar në dhomën numër 9 ndërsa Y. ka ardhur me një femër me një veturë Audi”, A.2 nuk e di a ka ardhur si musafirë i rregullt, A.1 dhe Y. po kanë ardhur bashkë dhe kanë ndenjtur, nuk e di datën, mirëpo mund të jetë një muaj më herët, për A.1 dhe Y. e kam fjalën kurse për këtë tjetrin nuk e di deri në atë ditë, është e saktë ajo që kam thënë se e kam përzënë A.1 se shkaktonte probleme mirëpo edhe ajo më herët që thash që janë vonuar dhe inspeksioni më kanë dënuar mua sepse nuk kanë dalur me kohë dhe kjo shkaktonte problem, nuk ka pasur ndonjë problem në motel para këtij rasti nga të akuzuarit, nuk e kam prekur derën, kam trokitur në xham, kanë dalur për 4 apo 5 minuta pasi që kam ardhur, Y. është larguar me kerr të vet dhe A.1 me kerr të vet, makinën A.1 e ka nxjerr vet, me dije tem personi që tani është në sallë (i referohet të pandehurit A.M) është K., krejt e kam parë 2 apo 3 here, e di që një ka qenë me të por nuk e di kush, nuk e di nuk më kujtohet, ai ka qenë pa mjekërr, kush ka dalur nuk e di saktë, kur kam arritur në oborr kanë qenë të parkuara dy vetura, kamera të sigurisë kemi por vetëm 24 orë jo

më shumë, veturën Jetta ngjyrë e kaltër e kam parë ka qenë e parkuar aty është endur dy herë, ka qenë e parkuar tek agregati, kur kam ardhur me dije tem nuk ka qenë, Jetta ka ardhur gjatë kohës sa kam qenë në ndrim, vetëm nëse ka ardhur pas orës 11 në natës, ditën ka qenë ka pru diçka ka ndenjë, ka qenë automjeti dhe është larguar, ka qenë mund të them dy apo tri herë, ditën kritike e kam parë veturën Jetta ka qenë aty, nuk kam qenë kur ka ardhur i akuzuari A.2, në mëngjes kur ka dalur ka qenë me femër, të gjithë kanë dalur bashkë në grup.

IV. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022 janë administruar këto prova materiale: *Raportet policore të dt.14-17.12.2021, Shënimi zyrtar i dt.17.12.2021, DeklA.t e të dëmtuarit të dhëna në polici dhe prokurori, Raportet mjekësore në emër të të dëmtuari si në lëndë, Eskpertziza mjeko-ligjore për dëmtimet e pësuar nga i dëmtuari Y.K, e dt.21.02.2022, Fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, Cd-në me video incizime si në shkresat e lëndës.*

Mbrojtësit dhe të akuzuarit kanë dhënë vërejtjet e tyre në raport me provat e caktuara ashtu siç konstatohet në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor dt.15.06.2022. Prokurori i Shtetit, i dëmtuari, mbrojtësit dhe të akuzuarit nuk kanë pasur propozime për plotësimin e procedurës së provave.

V. Marrja në pyetje e të akuzuarve

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022, të akuzuarit janë udhëzuar për të drejtat e tyre në bazë të nenit 323 dhe nenit 346 të KPP-së.

I akuzuari A.H ka deklaruar se i kam thënë dy deklarata në polici dhe në prokurori, kjo ka ndodh në efekt për shkak të pijes që kena qenë të dehur, mbes pranë deklaratës në polici dhe në prokurori andaj do të shfrytëzoj të drejtën time që të mbrohem në heshtje, kjo është bërë në konsultim edhe me mbrojtësin tim.

I akuzuari A.M ka deklaruar se do të shfrytëzoj të drejtën time ligjore që të mbrohem në heshtje, qëndroj pas deklaratave të dhënë paraprakisht në këtë çështje, këtë e bëjë pas konsultimit me mbrojtësin tim.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor se është e drejtë ligjor e të akuzuarve që të mos deklarohen lidhur me çështjen e paraparë me nenin 323 par.2 nën par.2.1 dhe 346 par.1 të KPP-së.

VI. Fjala përfundimtare

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 Prokurori i Shtetit ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se të akuzuarit A.H dhe A.M sipas aktakuzës me numër PP.I.nr.333/2021, janë akuzuar për veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 pika 2.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe atyre të nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësor, si nga dëshmia e të dëmtuarit Y.K, dhënë si në Polici, Prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor, provohet kryerja e veprës penale si më lart, fakt ky që është edhe identik edhe me pamjet dhe videot që gjenden në CD, ku shihet i dëmtuari me lëndimet e pësuar, dhe veprimet e të pandehurve, në këtë videoinqizim, shihet përdorimi i dhunës, psiçike dhe fizike ndaj të dëmtuarit, e cila dhunë është ndërprerë kur i

dëmtuari kishte pranuar një gjë të cilën nuk e kishte bërë, dhe atë kinse ka pasur marrëdhënie seksuale me të dashurën e të pandehurit A.1, në dëshminë e të dëmtuarit, ceket edhe qëllimi i kryerjes së veprës penale sipas të cilës janë akuzuar, ku ceket përfitimi pasuror i shumë prej 50 mijë euro, nga dëshmia e dëshmitarit M.Sh është cekur fakti se ditën kritike deri sa ishte në punë – duke pastruar, cekë se është dëgjuar një zhurmë, ku më pas e kishte ftuar edhe pronarin e motelit kurse nga dëshmitari R. po ashtu ceket fakti se në telefon e kishte thirrur nga Villa H., që të vijë në dhomën numër 9 se është duke ndodhur diçka, ku i njëjti kishte ardhur dhe të pandehurit e të dëmtuarin i kishte larguar nga moteli, gjithashtu cek faktin se të pandehurin A.1, për shkak të problemeve që ishin bërë në këtë motel e kishte përzënë, nga ekspertiza mjeko-ligjore që gjendet në shkresat e lëndës provohet fakti se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore nga të pandehurit në pjesën e fytyrës dhe pjesët e poshtme të këmbëve, ku i dëmtuari edhe më herët kishte cekur se lëndimet i kishte pësuar nga mjeti i fortë, bisht i sakicës dhe lëndimet në kokë me grushta, andaj nga këto që u theksuan, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe propozoj Gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor për veprën e kryer penale që ju vihet në barë sipas aktakuzës dhe ti gjykoj sipas ligjit duke marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit rrethanat lehtësuese dhe dënuese të parapara me ligj.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 i dëmtuari Y.K në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se e mbështes deklarin e Prokurorit të Shtetit dhe kërkoj që të njëjtit të dënohen sipas ligjit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 mbrojtësi i të akuzuarit A.H, av.Shyqyri Syla e ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se me asnjë provë të administruar në këtë shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar teza e akuzës se i mbrojturi im A.H në bashkëkryerje me të pandehurin tjetër A.M kanë kryer veprën penale të rrëmbimit sikurse që ju vihet në barrë nga akuza e Prokurorit të Shtetit, në të vërtetë disa prej provave të propozuara dhe administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, nuk e kanë cilësinë e provës të pranueshme materiale në kuptim të nenit 259 të KPP-së sepse nuk provojnë asnjë element të veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, siç parashikon kjo dispozitë, dhe rrjedhimisht provat e tilla dalin të jenë të pa mbështetshme, janë të pavlera në kuptim të provës por jo edhe në kuptimin informues siç janë shënimet zyrtare dhe raportet policore, ndërkaq provat e tjera të administruara ndonëse ligjërisht e kanë cilësinë e provës së pranueshme materiale siç është dokumentacioni dhe certifikata mjekësore, po ashtu Cd që ne patëm vërejtje se është incizim i paautorizuar që nuk i dihet data e as origjina megjithatë janë të pamjaftueshme një vëzhgues objektiv se është kryer vepra penale dhe se kryesi i saj është i mbrojturi im A.H së bashku me të bashkëakuzuarin A.M, kështu që këto tri prova materiale dhe tri të tjera personale që janë dëshmia e të dëmtuarit Y.K dhe dëshmitarëve M.Sh dhe R.M, nuk përmbushin dyshimin e bazuar mirë dhe nuk vërtetojnë se i pandehuri A.H së bashku me të pandehurin A.M se ditën kritike e paskan mbajtur të dëmtuarin Y.K në dhomën numër 9 të motelit H. në Stanovc të Vushtrrisë dhe se gjatë kësaj kohe kanë ushtruar dhunë duke goditur me grushta në pjesë të trupit dhe duke i shkakuar lëndime trupore, e që qëllimi paska qenë që mos ta lirojnë para se të pranoj se i njëjti ka pasur marrëdhënie seksuale me dashnoren e të pandehurit A.H dhe se me këtë rast është kanosur me fjalë të ndryshme dhe se i janë kërkuar para në shumë prej 50 mijë euro, këto pretendime të prokurorisë nuk janë vërtetuar me asgjë, në fakt nuk është kontestuese fakti se një përleshje dhe një zënkë verbale ka ndodhur, por ajo

ka ndodhur aty për aty dhe jo me parapërgatitje apo me paramendim të më hershëm, nuk është kontestuese as fakti se i dëmtuari në këtë rrahje ka pësuar lëndime të lehta trupore, pra me asnjë provë nuk është vërtetuar teza e akuzës se ndaj të dëmtuarit është përdorur ndonjë mjetë me të cilin kishin me u shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe kjo më së miri vërtetohet nga certifikata mjekësor e forenzikës ku është konstatuar se lëndimet janë të lehta dhe me pasoja të përkohshme gjë që bie fakti se të njëjtit kanë kryer veprën penale të rrëmbimit nga paragrafi 2 pika 2.3 neni 191 të KPRK-së, po ashtu nuk është vërtetuar as elementi tjetër i rrëmbimit, marrja e viktimës me dhunë, siç kërkohet me ligj, për faktin se viktimja ka shkuar vullnetarisht dhe ka ndenjur bashkë duke pirë birra siç thotë viktimja kokainë dhe atë pa e detyruar askush që të shkojë në motel, kjo vërtetohet nga vet deklarata e viktimës i cili e pranon se kanë qenë shokë dhe aty kanë shkuar për të pirë ku ka lindur konflikti verbal që ka ardhur deri tek rrahja ku i dëmtuari ka pësuar lëndimet trupore, i dëmtuari edhe gjatë ballafaqimit këto me deklaratat e tij ndërron deklaratat, dhe këtë e bënë me qëllim të vështirësimit të pozitës së të mbrojturit tim, në fakt i dëmtuari deklarojë se është rrahur pa ndërprerë gjë që demantohet nga deklarata e dëshmitarit M.Sh i cili deklaron se nga ora 10 ka dëgjuar një zhurmë dhe këtë zhurmë nuk e kishte dëgjuar më herët pasi që kishte filluar punë në ora 7 të mëngjesit dhe për këtë zhurmë e kishte njoftuar pronarin e motelit R.M i cili kishte arritur dhe sipas dëshmisë së këtij dëshmitari me të arritur në motel H. kishte kërkuar nga të pandehurit që të lëshoj dhomën dhe të njëjtit kishin vepruar kështu dhe e kishin lëshuar dhomën, se dëshmisë së të dëmtuarit nuk duhet falur besimi dhe duhet konsideruar si jo kredibile më së miri e dëshmojnë këto dy dëshmitarë, të cilët theksojnë se ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:20 minuta ndërsa aty kanë dalur rreth orës 11:10 minuta, që demantojnë në tërësi pohimet e të dëmtuarit se aty kanë qenë deri në ora 13, se kjo dëshmi është jo kredibile mund të vërtetohet po ashtu nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe video incizimi, që ne pamë sot, ku shihet se në dhomë nuk kishte asnjë shishe të thyer por kishte shishe të zbrazëta të birrës dhe pije të tjera që këta të gjithë i kishin konsumuar së bashku, po ashtu edhe dëshmitari Sh. dhe M. dëshmojnë faktin se në dhomë nuk kishin gjetur asnjë gjurmë tjetër përveç shisheve të zbarsta të birrës dhe pijeve të tjera, dëshmia e të dëmtuarit duhet refuzuar si e pabazë, tendencioze dhe qëllim keq për të vështirësuar pozitën e të pandehurve, nuk është dëshmuar me asnjë provë se nga i dëmtuari është kërkuar shuma e të hollave që ceket në aktakuzë, por përkundrazi u dëshmuar se në fund të kësaj ngjarje këto i mbrojturi im A.H me kërkesën e të dëmtuarit i kishte dhënë 50 euro me qëllim të shkuarjes tek mjeku, andaj fakti se ka marrë para nga i dëmtuari dhe fakti se i pandehuri ka kërkuar shumën e cekur të hollave nuk qëndrojnë së bashku, i dëmtuari po ashtu para gjykatës ka pohuar se kanë qenë shokë dhe i mbrojturi im e ka ndihmuar disa herë qoftë duke i ofruar para borgj ose duke i sjellur dhurata babait të tij, gjë që e dëshmon më së miri që qëllimi i të mbrojturit tim nuk ka qenë që ta mbajë të dëmtuarin me qëllim të plotësimit të kërkesave të tij, respektivisht shumës prej 50 mijë euro, por ka qenë një konflikt spontan që ka ndodhur aty për aty, e duke pasur parasysh faktin se të gjithë kanë qenë në gjendje të dehur, sigurisht që ky konflikt nuk ka mundur që të kontrollohet dhe ka eskaluar në dhunë fizike, andaj për këto arsye ne mendojmë se nuk është vërtetuar se i mbrojturi im së bashku me të pandehurin A.M kanë kryer veprën penale që i vihet në barë sipas akuzës së prokurorit të shtetit, por që mendojmë që eventualisht në veprimet e të pandehurve mund të ketë elemente të veprës penale lëndim i lehtë trupore, apo edhe elemente të veprës penale të kanosjes por asesi elemente të veprës penale rrëmbimi siç e ngarkon akuza e prokurorit të shtetit, për këto arsye propozoj që i mbrojturi im të lirohet nga akuza në mungesë të provave, e siç thash edhe më herët nëse gjykata gjenë se ka

elemente të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor apo të kanosjes e që gjykata nuk është e lidhur me kualifikimin juridik të akuzës ta shpall fajtor për këtë vepër penale dhe nëse e shpall fajtor për këtë vepër duke pasur parasysh një mori rrethanash lehtësuese të anën e të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim sa më të butë, si rrethanë lehtësuese duhet vlerësuar faktin se i njëjti është i martuar dhe baba i katër fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, më parë i pagjykuar me aktgjykim të formës së prerë, pendimin e tij për ngjarjen që ka ndodhur dhe kërkim faljen, dhe konsideroj se këto rrethana arsyetojnë një dënim minimal me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit, pra e kam fjalën nëse shpallet fajtor për veprën penale të kanosjes apo lëndimit të lehtë trupor, ndërsa për këtë vepër duhet që të lirohet, po ashtu i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim ti abrogohet masa e paraburgimit sepse tani kanë pushuar kushtet për këtë masë dhe se konsideroj se gjatë kësaj kohe në paraburgim është arritur efekti i tij.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 i akzuari A.H e ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se e përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojturit tim, i kërkoj falje palës së dëmtuarit, dhe pendohem për veprimet e bëra.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 mbrojtësi i të akzuarit A.M, av.Arlind Jupolli e ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se që nga fillimi i kësaj procedure penale e kemi kontestuar aktin akuzues në mungesë të individualizimit të veprimeve për secilin të akzuar, kjo për faktin se në dispozitivin e aktakuzës, vetëm në një rresht përshkruhet veprimi i të mbrojturit tim dhe asnjë e dhënë tjetër lidhur me kohën, vendin dhe mënyrën e supozuar të kryerjes së kësaj vepre penale, në tërë procedurën e zhvilluar gjyqësore, pa mëdyshje është vërtetuar vetëm një fakt, se i mbrojturi im ka qenë në vend ngjarje vetëm disa minutave ashtu siç kishte deklaruar në fillim të deklaratave të tij, kjo më se miri është vërtetuar edhe nga deklarimi i të dëmtuarit para trupit gjykues ku i njëjti deklaroj se i mbrojturi im ka qëndruar aty vetëm disa minuta dhe nuk ka pasur qëllim ndonjë përfitim, organi i akuzës përkundër barrës së provës nuk arriti që të vërtetojë qëllimin e të mbrojturit tim për të kryer veprën penale që i vihet në barrë si element qenësor i kësaj vepre penale, për më tepër në këtë procedurë nuk u arrit që të vërtetohet kualifikimi juridik i veprës penale i rënduar siç është në aktakuzë, lidhur me provat e administruara në këtë proces gjyqësor, mbrojtja konsideron se në raport me të mbrojturin tim, me asnjë provë të vetme nuk u vërtetua se i mbrojturi im mund të ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë, siç dëgjuam nga dëshmitarët asnjëri nga ta nuk e kanë parë të mbrojturin tim të qëndroj në vendin e ngjarjes në motel dhe siç theksoj edhe i dëmtuari i njëjti ka qëndruar për disa minuta, në fakt në ditën kritike, i mbrojturi im ka shkuar në motel duke kuptuar se i bashkëpandehuri është duke u sulmuar por me të kuptuar se nuk ka qenë situata e tillë menjëherë është larguar për shkak se e kishte lënë djalin e tij të sëmur tek miqtë dhe duhej të kujdesej për të, i mbrojturi im në deklaratën e tij e ka pranuar se e ka goditur të dëmtuarin, por pa e ditur se për çka është fjala, për këtë arsye insistimin e të mbrojturit tim dhe familjarëve të tij, familja e tij e ka kontaktuar viktimën dhe familjen e tij dhe me dt.06.05.2022 kanë arritur marrëveshje për pajtim familjar, me çka që të dy familjet janë pajtuar dhe ngjarjen e ndodhur ja kanë falur familjes M., këtë fakt e ka pohuar edhe vet i dëmtuari gjatë deklarimit të tij, siç u theksua edhe më herët eksperimenta mjekësore e ka vërtetuar se lëndimet e pësuar nga i dëmtuari janë të natyrës së lehtë dhe me pasoja të përkohshme për shëndetin e tij, duke konsideruar se gjatë kësaj procedura nuk ka mundur që të vërtetohet teza e akuzës, mbrojtja konsideron se sipas dispozitave të KPP-së,

gjkata nuk lidhet sipas kualifikimit juridik nga ana e organit të akuzës dhe në këtë kuptim e lusim gjykatën që gjatë vendosjes të ketë parasysh të gjitha rrethanat e rastit për të ardhur tek një vendim i bazuar në ligj, mbrojtja konsideron se bazuar në dispozitat lidhur me qëllimin e dënimit të ketë parasysh edhe rrethanat lehtësues në raport me të mbrojturin tim siç është pajtimi me familjen e të dëmtuarit, deklarin e të dëmtuarit lidhur me qëndrimin e të mbrojturit tim në ditën kritike, pendimin e të mbrojturit tim të shprehur si dhe rrethanat e tij personale dhe familjare, në këtë kuptim lidhur me veprën penale të Rrëmbimit të merr aktgjykim lirues dhe nëse gjykata konstaton se ka elemente të ndonjë vepre penale tjetër të mbrojturit tim ti shqiptoj ndonjë dënim të butë për shkak se i mbrojturi im kurrë më parë nuk është dënuar me vendim të formës se prerë, po ashtu Gjykatës i propozoj që masën e paraburgimit ta ndërpresë për shkak se kanë pushuar të gjitha rrethanat për çka është caktuar dhe vazhduar paraburgimi.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.06.2022 i akuzuari A.M e ka paraqitur fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ku ka theksuar se e mbështes deklarin e mbrojtësit tim, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe jam penduar për këtë çështje.

VII. Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor dhe shpallja publike e aktgjykimit

Kryetari i trupit gjykues e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor me dt.15.06.2022, kurse shpallja publike e aktgjykimit është bërë me dt.16.06.2022, në të cilën shpallje ka qenë prezent mbrojtësi av.Shyqyri Syla dhe i dëmtuari Y.K, kurse nuk kanë prezentuar, Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësi av.Arlind Jupolli.

VIII. Gjetjet e gjykatës, vlerësimi i provave dhe rikualifikimi i veprës penale

VIII/1. Gjetjet e Gjykatës

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar të gjitha provat e çështjes dhe dëshmitë e dëshmitarëve, ka bërë vlerësimin e secilës provë dhe dëshmi të dëshmitarëve veç e veç në raport me fuqinë provuese të tyre për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së, e rikualifikuar nga ana e Gjykatës.

VIII/2. Faktet jokontestuese

Gjykata bazuar në dëshminë e të dëmtuarit Y.K të dhënë në cilësinë e dëshmitarit, dëshmitë e dëshmitarëve M.Sh dhe R.M po ashtu në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të renditura si në pikën II/2 të këtij Aktgjykimi arriti në përfundim se faktet e cekura si më poshtë nuk janë fakte kontestuese:

1. Me dt.14.12.2021 rreth intervalit kohor 00:00 deri në orën 11:30, të akuzuarit A.H dhe A.M si dhe i dëmtuarit Y.K kanë qenë prezent në hapësirat e moteli “H.” në fshatin Stanovc të Vushtrrisë.

2. I dëmtuari Y.K, nga goditja e marra nga të akuzuarit A.H dhe A.M me dt.14.12.2021, brenda hapsirave të motelit “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë, ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Fakti se të akuzuarit dhe i dëmtuari kanë qenë prezent rreth intervalit kohor 00:00 deri në orën 11:30 minuta në hapësirat e motelit “H.” në fshatin Stanovc të Vushtrrisë, për Gjykatën nuk kanë qenë kontestuese në asnjë fazë të procedurës, po ashtu ky fakt nuk ka qenë kontestues as për të akuzuarit dhe të dëmtuarin, pasi që pikërisht në deklaratimet e tyre të njëjtit e kanë pohuar këtë fakt, e po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve M.Sh dhe R.M të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022.

Fakti se të akuzuarit e kanë goditur të dëmtuarin Y.K me dt.14.12.2021, brenda hapësirave të lokalit “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë dhe si pasojë e këtyre goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, nuk ka qenë fakt kontestues për Gjykatën e po ashtu edhe për të akuzuarit dhe të dëmtuarin, pasi që të akuzuarit në asnjë fazë të procedurës nuk e kanë mohuar faktin se e kanë goditur të dëmtuarin brenda hapësirave të motelit “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë, e që ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e të dëmtuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe Cd-ja me video incizimet, po ashtu fakti se lëndimet e pësuar nga i dëmtuari bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin vërtetohet nga Ekspertiza Mjeko-Ligjor e dt.21.02.2022.

VIII/3. Faktet kontestuese

Kontestuese në këtë çështje ka qenë fakti se të akuzuarit a i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese në drejtim të veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 pika 2.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë?

Prokuroria në rastin konkret të akuzuarit sipas përshkrimit faktit të dispozitivit të aktakuzës i ka akuzuar se me dt.14.12.2021, kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese në drejtim të veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 pika 2.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që të njëjtit në intervalin kohor nga ora 00:00 minuta deri në orën 11:30 minuta në motelin “H.” në Stanovc të Vushtrrisë pas marrëveshjes paraprake mes vete, e mashtrojnë të dëmtuarin dhe e dërgojnë në motelin e lartcekur, me qëllimin që ta mbajnë të njëjtin për ta detyruar për të pranuar një veprim të cilin nuk e ka bërë se kinse ka pasur marrëdhënie seksuale me të dashurën e të akuzuarit A.H – A.T – A., ku pasi kanë hyrë në dhomën numër 9 të motelit, i akuzuari A.1 e ka kanosur me fjalë të dëmtuarin “kam me ta nxjerr shpirtin derisa te pranosh se ke pasur marrëdhënie seksuale me A.”, pastaj ka ardhur edhe i akuzuari A.2 ku të dy kanë filluar të ushtrojnë dhunë psikike dhe fizike duke e rrahur të dëmtuarin, ku fillimisht i akuzuari A.2 me shkop druri e godet në pjesën e poshtme të këmbëve nën gjunjë e më pas që të dy me grushte në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, me qëllim të detyrimit që i dëmtuari Y. të pranojë një fakt që nuk ka ndodhur, ku pasi që të akuzuarit kanë vazhduar ta malltretojnë fizikisht dhe psikikisht i akuzuari A.1 e kanos me fjalët “kam me të dërguar në Shqipëri o qen se më ke pre në besë deri sa të mi sjellësh 50.000 euro”.

Gjykata në rastin konkret gjen se Prokuroria i ka akuzuar të akuzuarit se kanë kryer formën e kualifikuar të veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 konkretisht paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të KPRK-së, pasi që sipas pretendimeve të Prokurorisë të akuzuarit në rastin konkret kanë përdorur mjetin e rrezikshëm apo sendin tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, ku në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës theksohet

fakti se "...i akuzuari A.2 me shkop druri e godet në pjesën e poshtme të këmbëve nën gjunjë e më pas që të dy me grushte në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit...", pra është fjala për të dëmtuarin Y..

Gjykata në rastin konkret bazuar në vlerësimin e provave dhe dëshmimeve të dëshmitarëve gjeti se nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimin inkriminues në formën e kualifikuar e veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par.2.3 të KPRK-së, pasi që nuk është vërtetuar fakti kryesor i pretenduar nga ana e Prokurorisë së të akuzuarit kanë përdorur mjetin apo sendin e rrezikshëm me të cilin kanë mundur që të dëmtuarit t'i shkaktojnë lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit.

Fillimisht Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar provat në shkresat e lëndës dhe atë CD-në me video incizim dhe Foto dokumentacionin në shkresat e lëndës dhe nuk ka arritur që të vërtetojë në bazë të këtyre provave se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminues nga forma e kualifikuar e veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par.2.3 të KPRK-së, konkretisht në bazë të këtyre provave nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë përdorur ndonjë mjetë të rrezikshëm apo send që ka mundur të dëmtuarit t'i shkaktojë lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit.

Nga Cd-ja me video incizimet shihet të akuzuarit në vendin e ngjarjes në hapësirat e motelit "H." në fashtin Stanovc të Vushtrrisë, duke e goditur të dëmtuarin me grushte konkretisht shihet i akuzuari A.M duke e goditur të dëmtuarin me grushte në pjesë të ndryshme të trupit dhe i akuzuari A.1 duke incizuar dhe duke e kërcënuar me fjalë të dëmtuarin, ***mirëpo në asnjë moment nuk shihet se të akuzuarit e kanë goditur të dëmtuarin me ndonjë mjetë që kanë pasur në posedim konkretisht në duar ndonjë mjetë të rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit.***

Po ashtu nga Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, ***nuk shihet në ndonjë nga fotografitë se është gjetur ndonjë mjetë ose send i rrezikshëm në vendin e ngjarjes me të cilin të akuzuarit kanë mundur që të shkaktoj lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit të dëmtuarit,*** e për më tepër Gjykata gjen se në rastin konkret ***nuk kemi ndonjë vërtetim në shkresat e lëndës se nga të akuzuarit është sekuestruar ndonjë mjetë apo send i tillë.*** Po ashtu Gjykata thekson edhe faktin se dëshmitarët M.Sh dhe R.M në dëshmitë e tyre të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022, ***nuk e kanë potencuar askund faktin se në duart e të akuzuarve ka parë ndonjë mjetë apo send në momentin kur kanë dalur nga moteli.***

Andaj për Gjykatën, fakti se të akuzuarit e kanë goditur me mjetë të rrezikshëm apo send që ka mundur të dëmtuarit t'i shkaktojë lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit, ashtu siç pretendohet nga ana e Prokurorisë, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë duke u bazuar në provat në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e lartcekur.

Gjykata në rastin konkret, duke vlerësuar se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit në kryerjen e veprës penale kanë përdorur ndonjë mjetë të rrezikshëm apo send që ka mundur të dëmtuarit t'i shkaktojë lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të

shëndetit, ka bërë rikualifikimin e veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par.2.3 të KPRK-së, në veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së, pasi që është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese të veprës penale të rikualifikuar bazuar në arsyetimin si më poshtë.

Fillimisht Gjykata pra e rithekson se në pikën VIII/2 të këtij aktgjykimi është konstatuar se është fakt jokontestues se me dt.14.12.2021 rreth intervalit kohor 00:00 deri në orën 11:30, të akuzuarit A.H dhe A.M si dhe i dëmtuarit Y.K kanë qenë prezent në hapësirat e moteli “H.” në fshatin Stanovc të Vushtrrisë, e kjo bazuar në arsyet dhe provat e lartcekura si në këtë pikë të Aktgjykimit.

Të akuzuarit në deklaratat e tyre të dhëna në polici dhe në Prokurori e që kanë qëndruar pranë tyre edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.06.2022, kanë theksuar faktin se nuk e kanë pasur qëllimin e ndërmarrje së veprimeve inkriminuese të veprës penale për të cilën janë akuzuar nga ana e Prokurorisë, konkretisht nuk i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese të veprës penale për të cilën janë akuzuar nga ana e Prokurorisë, mirëpo të njëjtit kanë theksuar se ndihen fajtor për elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor.

Gjykata bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe dëshmitë e dëshmitarëve gjen se pretendimet e të akuzuarve nuk qëndrojnë si të tilla dhe se pretendimet e tilla të akuzuarve janë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale të kryer.

Gjykata thekson se vepra penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së, përbëhet nga elementet e dhunës, kanosjes, mashtrimit dhe formave të tjera me qëllim të privimit të lirisë së personit të rrëmbyer dhe detyrimin që i njëjti të veprojë ose mos veprojë diçka deri në përmbushjen e kërkesës së kryesit të veprës, ku mbajtja e personit në një vend të caktuar bëhet me qëllim që ai të mos lirohet deri sa të përmbushet qëllimi i rrëmbimit.

Gjykata në rastin konkret bazuar në përshkrimin e dispozitivit të aktakuzës, provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmisë së të dëmtuarit Y.K në cilësinë e dëshmitarit, dëshmive të dëshmitarëve M.Sh dhe R.M të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu duke u bazuar edhe në deklaratimet e të akuzuarve të dhëna në Polici dhe Prokurori, Gjykata arriti që të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminues të veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së, e rikualifikuar nga ana e Gjykatës.

Fillimisht Gjykata gjen se të akuzuarit po ashtu edhe i dëmtuari nuk e kanë mohuar faktin se ditën kritike me dt.14.12.2021 në intervalin kohor prej orës 00:00 minuta deri në orën 11:30 minuta, kanë qenë brenda hapësirave të motelit “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë e që ky fakt është jokontestues për Gjykatën dhe palët në procedurë.

Gjykata bazuar në përshkrimin e dispozitivit të aktakuzës ku theksohet se “... të pandehurit sipas marrëveshjes paraprake në mes veti e mashtrojnë të dëmtuarin Y., e dërgojnë në motelin H. aty ushtrojnë dhunë fizike dhe psikike ...”. Gjykata gjen se në rastin konkret bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe dëshmitë e dëshmitarëve është vërtetuar

përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminues si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës.

Gjykata gjen se në rastin konkret bazuar në dëshminë e të dëmtuarit Y.K në cilësinë e dëshmitarit i njëjti ka theksuar se i akuzuari A.H e ka thirrur të njëjtin që të shkojnë së bashku në motelin “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë dhe atje të kalojnë kohë në shoqërinë e disa shoqeve të tyre ku i dëmtuari në këtë rast pranon dhe takohet me të akuzuarin A.1 dhe të njëjtit shkojnë së bashku në motelin “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë dhe kur të njëjtit mbërrijnë në motelin “H.” i akuzuari A.1 ja merr telefonin të dëmtuarit Y. ku pas një kohë fillon që të njëjtin ta godas dhe të ushtrojë dhunë psiçike ndaj tij ku më vonë vjen edhe i akuzuar A.2 dhe po ashtu i njëjti fillon që të ushtrojë dhunë fizike ndaj tij me qëllim që i njëjti të pranojë një fakt të cilin nuk e ka bërë, ku nga i dëmtuari është kërkuar shuma prej 50000 euro pasi që i njëjti pas ushtrimit të dhunës fizike dhe psiçike nga ana e të akuzuarve ka pranuar faktin për të cilin nuk e ka bërë. Pra në rastin konkret Gjykata në bazë të lartcekurave ka arritur që të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit me anë të mashtrimit kanë arritur që të dëmtuarin t’a dërgojnë në motelin “H.”, duke i thënë se atje do të kalojnë kohë së bashku me shoqëri dhe i dëmtuari mbi këtë bazë ka shkuar në motelin “H.”.

Gjykata në rastin konkret i ka falur besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit Y.K të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor në raport me faktet të cilat i njëjti ka deklaruar duke pas parasysh se dëshmia e të dëmtuarit është në përputhje të plotë edhe me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë Cd-në me video incizimin.

Fakti se deklarata e të dëmtuarit Y.K është në përputhje të plotë edhe me Cd-në me video incizim vërtetohet edhe nga përmbajtja e Cd-së – video incizimit ***pasi që nga përmbajtja e saj shihen të akuzuarit A.H dhe A.M duke ushtruar dhunë psiçike dhe fizike ndaj të dëmtuarit Y.K dhe i akuzuari A.1 gjatë kohës sa ushtronte dhunë psiçike ndaj të njëjtit dhe incizonet të akuzuarin A.2 duke e goditur të dëmtuarin Y., i akuzuari A.1 e kërccënon të dëmtuarin Y. që të pranojë një fakt se i dëmtuari ka pasur marrëdhënie seksuale me të dashurën e të akuzuarit A.1.***

Bazuar në të lartcekurat pasi që Gjykata i fal besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit Y.K pasi që e njëjta nuk ka kundërthënë me provat e tjera siç është Cd-ja me video incizimin, Gjykata i fal besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit edhe në raport me faktin se të akuzuarit kanë pasur qëllimin e përfitimit material nga i dëmtuarit pasi që i akuzuari A.1 ka kërkuar nga i njëjti shumën prej 50000 euro në mënyrë që të liroj të dëmtuarin, pasi që i njëjti nga dhuna e ushtruar psiçike dhe fizike nga të akuzuarit është detyruar dhe ka pranuar një fakt jo të vërtetë. Pra në rastin konkret duke pas parasysh se dëshmia e të dëmtuarit është në përputhje të plotë me Cd-në me video incizime, Gjykata i fali besimin e plotë edhe në raport me faktin se të akuzuarit kanë pasur qëllimin e përfitimit pasuror-materiale për vete me rastin e ndërmarrjes së veprimeve inkriminuese të veprës penale.

Fakti se i dëmtuari është mbajtur në motelin “H.” në fshatin Stanovc dhe i njëjti nuk është liruar deri sa ka pranuar një fakt jo të vërtetë dhe pranimin e këtij fakti e ka bërë për shkak të ushtrimit të dhunës psiçike dhe fizike nga të akuzuarit, vërtetohet edhe nga vet deklarimet e të

akuzuarve të dhëna në Polici dhe në Prokurori, ku të njëjtit në asnjë moment nuk e mohojnë faktin se kanë qenë në motelin “H.” në fshatin Stanovc në Vushtrrisë dhe se të njëjtit kanë ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarit, po ashtu faktin se i dëmtuari është mbajtur në motelin “H.” nga të akuzuarit vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarit të cilës deklaratë Gjykata me sqarimet si më lart i ka falur besimin e plotë në raport me faktet e cekura nga i dëmtuarit.

Po ashtu faktin se të akuzuarit e kanë mbajtur të dëmtuarin në motelin “H.” gjatë periudhës kohor nga ora 00:00 minuta deri në ora 11:30 minuta vërtetohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve M.Sh dhe R.M, ku deklaratave të këtyre dëshmitarëve Gjykata i ka falur besimin e plotë pasi që të njëjtat nuk kanë pasur kundërthënie me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe të njëjtit kanë deklaruar se të akuzuarit dhe i dëmtuari kanë qenë prezent në motelin “H.” ditën kritike gjatë periudhës kohore, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit R.M vërtetohet fakti se kur kanë dalur nga dhoma e motelit i akuzuari Y. ka pasur lëndime të pësura në fytyrë dhe gjatë kohës së qëndrimit të akuzuarve dhe të dëmtuarit në motelin “H.” janë dëgjuar zhurma brenda asaj dhome nga një zë i mashkullit.

Pra Gjykata në rastin konkret bazuar në provat e lartcekura siç janë dëshmia e të dëmtuarit Y.K, dëshmitarëve R.M dhe M.Sh dhe Cd-ja me video incizimet arriti që të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminues të veprës penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së, konkretisht të akuzuarit është vërtetuar se kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese të veprës penale dhe atë se të njëjtit me anë të mashtrimit, duke përdorur dhunë psiçike dhe fizike e kanë mbajtur të dëmtuarin në motelin “H.” në fshatin Stanovc Komuna e Vushtrrisë, me qëllimin që i njëjti të pranojë një fakt i cili nuk ka qenë i vërtetë dhe që të akuzuarit vetëm pas përmbushjes së kërkesës së tyre (pas pranimit të faktik nga i dëmtuari si pasojë e dhunës psiçike dhe fizike nga të akuzuarit) kanë kërkuar para në shumë prej 50000 euro nga i dëmtuari në mënyrë që të përfitojnë dobi pasurore – materiale nga i dëmtuari.

Sa i përket provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë Raportet policore të dt.14-17.12.2021 dhe Shënimit zyrtar i dt.17.12.2021, Gjykata këtyre provave i fal besimin vetëm në raport me fuqinë provuese që të njëjtat kanë për vërtetimin e fakteve dhe nga ana e Policisë janë ndërmarrë veprimet ligjore lidhur me rastin konkret ku zyrtarët policor në këto raporte-shënim kanë paraqitur të gjeturat e tyre lidhur me rastin gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, andaj mbi këtë bazë Gjykata i fal fuqinë provuese provave të lartcekura.

Sa i përket Raporteve mjekësore në emër të të dëmtuarit, Gjykata këtyre raporteve i fal besimin e plotë pasi që të njëjtat janë vërtetuar konkretisht nuk ka kundërthënie me Ekspertizën Mjeko-Ligjore të dt.21.02.2022, lidhur me lëndimet e pësura nga i dëmtuari, konkretisht lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, andaj mbi këtë bazë provave të lartcekura Gjykata i fal besimin e plotë në raport me faktet që vërtetojnë.

Gjykata në rastin konkret ka vepruar në bazë të nenit 370 par.7 të KPP-së, ka vlerësuar secilën provë veç e veç në raport me të gjitha faktet të cilat i ka konstatuar si të vërtetuara dhe jo të vërtetuar po ashtu edhe faktet jokontestuese dhe kontestuese lidhur me çështjen, duke bërë rikualifikimin e veprës penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi pasi që është vërtetuar nga të

lartcekurat përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale Rrëmbimi nga neni 191 par.1 të KPRK-së.

IX. Korigjimi dhe plotësimi i dispozitivit të akuzës në përshkrimin faktik në bazë të gjendjes faktike si në aktgjykim

Në dispozitivin e Aktgjykimit në pikën është bërë përshkrimi faktik i veprimeve, i kualifikimit ligjor për veprën penale, i veprës penale për të cilën të akuzuari janë shpallur fajtor, korrigjim dhe plotësim i bërë në përshkrimin faktik të dispozitivit në përmbajtjen e fakteve dhe rrethanat të cilat përbejnë elementet e veprës penale konkretisht në bazë të provave në shkresat e lëndës, përshkrimi i fakteve dhe i rrethanave që nënkupton përshkrimin faktik të veprës, që në dispozitiv të Aktgjykimit pas administrimit të provave janë bërë plotësime në përshkrim faktik, i nevojshëm në raport me veprën penale të rikualifikuar nga ana e Gjykatës dhe nuk është bërë marrja mekanike e plotë e tekstit të Aktakuzës, kjo duke pasur mbështetje edhe në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale faqe 848, në komentim të nenit 365 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, ku citohet “Edhe pse sa i përket përshkrimit faktik të veprës duhet të ekzistojë identiteti ndërmjet aktakuzës dhe aktgjykimit, kjo nuk do të thotë se aktgjykimi duhet ta marrë në mënyrë mekanike dhe tekstualisht tekstin nga aktakuza”, kjo i referohet përshkrimit faktik duke mos cenuar në asnjë mënyrë identitetin objektiv pasi që është përcaktuar kualifikimi ligjor për veprën penale me të cilën akuzohen të akuzuarit dhe atë identiteti subjektiv pasi që në dispozitiv të aktgjykimit është i vërtetuar identiteti i palës së akuzuar.

X. Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të Aktgjykimit ku për të akuzuarin A.H si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë shprehjen e keqardhjes në raport me të dëmtuarin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, raportet e të akuzuarit A.1 dhe të dëmtuarit Y. ku të njëjtit paraprakisht kanë deklaruar se kanë pasur marrëdhënie shoqërore mes veti kurse si rrethana rënduese për të akuzuarin A.H, Gjykata ka marrë për bazë faktin e prezencës së dhunës, kanosjes dhe shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, kurse për të akuzuarin A.M Gjykata vlerësoj si rrethana lehtësuese shprehjen e keqardhjes për të dëmtuarin, rrethanat e tij familjare në raport me fëmijën e sëmurë sipas raporteve mjekësore për një gjendje serioze, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 38 KPRK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, andaj Gjykata nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të akuzuarin.

XI. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, Gjykata e ka marrë në bazë të nenit 453 të KPP-së, ndërsa udhëzimi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civilo-juridik u mbështet në nenin 463 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

DepA.menti për Krime të Rënda

PKR.nr.66/22 dt.28.06.2022

**Procesmbajtësi
Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Bekim Veliqi**

KËSH.A JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta ne ankese, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.